Vrasja e biznesmenit në lokal/ Autori ndoqi lëvizjet e 49-vjeçarit në zonën e Selitës

0 KOMENTE December 17, 2022

MË TË LEXUARAT

Ja cilat janë femrat që kanë nevojë urgj...

"Mjaft është mjaft"/ Kryeministri britan...

Kërkesa për vendosjen e forcave serbe në...

Vritet 49 vjeçari në lokal/ U qëllua me...

Bashkëpunoi me djalin dhe një person tje...

Subscribe

Detaje te reja janë zbuluar në lidhje me vrasjen e biznesmenit Edmond Papa, pasditen e së premtes në zonën e Selitës, në Tiranë.

49-vjeçari u qëllua me 9 plumba brenda një lokali vetëm pak minuta pasi kishte mbërritur aty. Burime bëjnë me dije se autori ka qenë i mirë informuar për lëvizjet e Papës.

Ndërsa kamerat e sigurisë së zonës kanë fiksuar momentin kur ndodhi ngjarja. Autori ka qëndruar për disa minuta në këmbë pranë pallatit ku banonte vëllai i 49-vjeçarit, e më pas është larguar sërish i vetëm.

Vrasësi mbetet ende i paidentifikuar nga policia, teksa grupi hetimor ka shoqëruar disa persona që ishin të pranishëm në vendin e ngjarjes. Gjithashtu janë sekuestruar dhe pamjet e kamerave të sigurisë, jo vetëm të vendit të krimit, por edhe subjekteve pranë, për të bërë të mundur identifikimin e autorit.

Edhe motivet e krimit mbeten të paqarta, ndërsa pista kryesore ku po hetohet është ajo e konflikteve të pronësisë.

Edmond Papa me origjinë nga Fieri prej shumë vitesh jetonte në Sarandë. Në qytetin bregdetar ai ishte pronar edhe i një hoteli luksoz. 49-vjeçari ka pasur precedentë penalë edhe në Greqi ku ka qenë i dënuar për trafik droge.

Posted Under: Kronike Kryesoret Vendi

Tagged: edmond papa Lokal Selite vrasje

Leave a Reply

Your email address will not be published. Required fields are marked *

Comment *

Name *

Email *

Website

Save my name, email, and website in this browser for the next time I comment.

Post Comment

SUBSCRIBE VIZION PLUS TV YouTube

TË TJERA NGA KRONIKE

Veliaj me personalitetet e Njësisë 7: Kontributi i vyer duhet vlerësuar, vetëm me besim dhe mirënjohje ecim përpara
më shumë...

Zjarr në komisariatin e Elbasanit/ I riu i vë flakën dritares së ankesave të qytetarëve
më shumë...

"Specialja" godet ish krerët e UÇK/ Analisti: Dënimi i Mustafës i pabazuar në prova, ja çfarë pritet të ndodhë
më shumë...

Një muaj paraburgim për serbin që dyshohet për krime lufte në Kosovë
më shumë...

TË TJERA NGA RAJONI

Shtohen trupat e KFOR në veri të Kosovës: Garantojmë lirinë e lëvizjes
më shumë...

SHBA përshëndet me 26 vite burg të ish-luftëtarit të UÇK: Jo vendim kundër Kosovës
më shumë...

KFOR merr në shqyrtim kërkesën e Serbisë për dislokimin e trupave
më shumë...

Trajkoviçit i përkeqësohet shëndeti, dërgohet me autoambulancë në Serbi
më shumë...

© VIZION PLUS TV ALBANIA 1999 - 2022
NDALOHET RIPRODHIMI I PAAUTORIZUAR I PËRMBAJTJES SE KESAJ FAQEJE.